

VENDIM
Nr. 127, datë 30.8.2012

**MBI KËRKESËN E GSA SHPK DHE “RUDNAP ENERGY TIRANA” SHPK MBI ZBATIMIN E
VENDIMIT NR.114, DATË 22.8.2012**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, germa “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.8.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë GSA sh.p.k. me nr. 29.8.2012 prot., datë 29.8.2012 dhe “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. mbi zbatimin e vendimit të ERE-s nr. 114, datë 22.8.2012, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

duke konsideruar se:

Vendimi nr.114, datë 22.8.2012, përcaktonte alokimin e kapaciteteve disponibël të interkonjeksionit për muajin shtator 2012 shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për sasinë 155 MW, për mbulimin e humbjeve të ndara sipas kufirit dhe periudhave të përcaktuara nga OST sh.a., si dhe klientëve të kualifikuar për sasinë 45 MW, të ndara proporcionalisht sipas kufirit dhe periudhave të përcaktuara nga OST sh.a. me kusht “CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe furnizuesit e kualifikuar të bëjnë nominimet dhe pagesat për kapacitetet e interkonjeksionit.

Në datën 29.8.2012, në kushtet e moszbatimit nga “CEZ Shpërndarje” të detyrimit sipas pikës 3 të vendimit nr. 114, datë 22.8.2012, OST zhvilloi ankandin për alokimin e kapaciteteve të akorduara sipas pikës 1 të këtij vendimi shoqërisë “CEZ Shpërndarje”.

Çmimet për kapacitet sipas kufijve përkatës në përfundim të ankandit rezultuan të ndryshëm nga çmimet e përcaktuara në ankandin vjetor të zhvilluara nga OST, duke vendosur subjektet e përcaktuara në vendimin 114, datë 22.8.2012 (furnizuesit e kualifikuar) në kushtet e pabarazisë me pjesëtarët e tjerë të tregut që ju alokuan kapacitet sipas ankandit të zhvilluar nga OST për muajin shtator 2012.

Vendimi 114, datë 22.8.2012 reflektonte parimin e barazisë në alokimin e kapaciteteve dhe pagesës përkatëse ndërmjet pjesëtareve të tregut.

Rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të miratuara nga ERE me vendimin nr. 13, datë 22.2.2011, përcaktojnë se llogaritja e çmimit përfundimtar për kapacitet bazohet në renditjen e ofertave duke filluar nga çmimi më i lartë për të përfunduar me çmimin më të ulët.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Subjektet e përcaktuara sipas detyrimeve në pikën 3 të vendimit nr. 114, datë 22.8.2012, do t'i paguajnë OST për kapacitetet e interkonjeksionit, sipas rezultateve dhe drejtimeve të përcaktuara në ankandin e zhvilluar në datën 29.8.2012, nga OST, për muajin shtator 2012.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve, shoqëritë OST sh.a., GSA sh.p.k., dhe “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. që preken nga ky vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani